

VENDIM
Nr. 14, datë 22.01.2019

MBI FILLIMIN E PROCESIT TË KRIJIMIT TË SKEMËS SË DELEGIMIT

Këshilli i Lartë Gjyqësor, i mbledhur në datën 22.1.2019, në përmbushje të përgjegjësiave për mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor, në respektim të parimit qeverisës të eficiencës, në ushtrim të kompetencave në lidhje me administrimin e gjykatave, bazuar në nenin 147 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, nenet 2 dhe 89, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në funksion të aplikimit të skemës së delegimit dhe asaj të transferimit të përkohshëm, sipas neneve 45 dhe 46, të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Fillimin e procesit për krijimin e skemës së delegimit, si dhe, deri në zbatimin e saj, për transferimin e përkohshëm në çdo gjykatë ku evidentohet nevoja për krijimin e trupës gjyqësore në rastin konkret.

2. Të kërkohet pëlqimi i të gjithë magjistratëve në gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit në Republikën e Shqipërisë, që pa lëvizur nga pozicioni ku është emëruar, për kandidimin në skemën e delegimit sipas nenit 45, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si edhe për dhënien e pëlqimit për transferimin e përkohshëm sipas nenit 46 të këtij ligji.

3. Dhënia e pëlqimit nga magjistratët të dokumentohet me një deklaratë me shkrim sipas formatit bashkëlidhur këtij vendimi, ku të evidentohet qartë pëlqimi i tij sa i përket kandidimit në skemën e delegimit dhe/ose për transferimin e përkohshëm.

4. Dhënia e pëlqimit me shkrim nga magjistratët të depozitohet, brenda datës 25.1.2019, pranë Kryetarit të Gjykatës ku magjistrati ushtron funksionin.

5. Kryetari i Gjykatës, brenda datës 26.1.2019, depoziton deklaratat për dhënien e pëlqimit të magjistratëve, në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

6. Në mungesë të dhënies nga magjistratët të pëlqimit sipas nenit 45, 46 të ligjit, Këshilli i Lartë Gjyqësor do të fillojë procedurat sipas nenit 46, pika 2, të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për përmbushjen e nevojave të gjykatave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR
KRYETARE
Naureda Llagami

DEKLARATË
PËR KANDIDIM NË SKEMËN E DELEGIMIT

Unë _____, aktualisht gjyqtar/e pranë Gjykatës _____, me vullnetin tim të lirë, mbështetur në nenin 45, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, shpreh pëlqimin për kandidim në skemën e delegimit që do të krijohet pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, dhe për t’u caktuar në këtë mënyrë në çdo gjykatë ku evidentohet nevoja për krijimin/plotësimin e trupës gjyqësore në rastet konkrete.

DEKLARUESI

(_____)

DEKLARATË
PËR DHËNIE PËLQIMI PËR TRANSFERIM TË PËRKOHSHËM

Unë _____, aktualisht gjyqtar/e pranë Gjykatës _____, me vullnetin tim të lirë, mbështetur në nenin 46 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, shpreh pëlqimin tim për transferimin e përkohshëm, nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, në çdo gjykatë ku evidentohet nevoja për krijimin/plotësimin e trupës gjyqësore në rastet konkrete.

DEKLARUESI

(_____)

